

## **Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Konferenca Shkencore Kombëtare "Tradita arsimore e Elbasanit nga mesi i shek.XIX deri në vitet '30 të shek XX"**

Konferenca u zhvillua në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Akademinë e Studimeve Albanologjike, Institutin e Historisë dhe Universitetin Shtetëror të Tetovës. Kjo konferencë, synon evidentimin, zbulimin dhe vlerësimin e traditës arsimore të qytetit të Elbasanit, që i kalon kufijtë e lokales, vlerësimin e kontributeve mbarëkombëtare të personaliteteve të trevës së Elbasanit në fushën e arsimit, të gjuhës e didaktikën shqipe, përfshirjen e studiuesve të njësive të ndryshme shkencore e akademike në këto projekte dhe po aq përfshirjen e studentëve me interesa në kërkimin shkencor.

Në fjalën e tij përshëndetëse, zëvendësrektori i universitetit, Prof.as.dr. Peçi Naqellari, vlerësoi organizimin e kesaj konference, punimet e së cilës kryesojnë dhe lartësojnë figurat e arsimit në traditën arsimore, si një trashëgimi të patjetërsueshme kulturore, intelektuale për brezat e sotëm dhe së ardhmes. Gjithashtu theksoi, se organizimi i konferencave të tilla shkencore, krijimi i faciliteteve infrastrukturore, programet bashkëkohore dhe realizimi i mobiliteteve jashtë vendit, e rendisin Universitetin e Elbasanit një ndër më të suksesshmit në vend.



